

VENDIM
Nr. 432, datë 13.7.2007

**PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA
MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT**

*(Ndryshuar me VKM nr. 605, datë 27.4.2009; nr. 627, datë 8.7.2010; nr. 561, datë
11.8.2011; nr. 499, datë 1.8.2012)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 22 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas detyrave që kryejnë në shërbim dhe funksioneve organike që kanë, klasifikohen në 4 nivele, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Struktura dhe nivelet e pagave, sipas niveleve të klasifikimit, për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit janë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga bazë mujore për klasë, sipas çdo niveli klasifikimi, është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Shtesa për gradë, sipas çdo niveli klasifikimi, është sipas kolonës 6 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas çdo niveli klasifikimi, u jepet shtesë për vjetërsi në punë, në masën 1 për qind, mbi pagën bazë mujore për klasë, por jo më shumë se 25 për qind, sipas kolonës 5 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

6. Të drejtën e pagës e gëzojnë edhe kursantët për periudhën, që vazhdojnë kursin e kualifikimit, pranë Institutit të Shërbimit Informativ të Shtetit. Paga e kursantit është sa paga minimale e inspektorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

7. Punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit, që marrin pagën sipas niveleve të klasifikimit të këtij vendimi, u jepet shtesë për vështirësi vendi dhe zone, në masën deri në 60 për qind të pagës bazë mujore.

Masa për çdo shtesë, vendi i punës, vështirësia e funksionit, si dhe kriteret për përfitimin e shtesës mbi pagë, përcaktohen me akt normativ të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

8. *Shfuqizuar.*

9. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit të nxjerrë aktet normative përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

10. Vendimet nr.56, datë 27.2.1992 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Kombëtar”, të ndryshuar, dhe nr.43, datë 7.2.2002 “Për pagesën e kandidatëve, që punësohen në Shërbimin Informativ Shtetëror” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2007.

(Ndryshuar me VKM nr. 605, datë 27.4.2009)

KLASIFIKIMI I FUNKSIONEVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT

Funksionet në shërbimin Informativ të Shtetit, klasifikohen në 4 nivele:

- I. Punonjës mbështetës;
- II. Punonjës të nivelit zbatues;
- III. Punonjës të nivelit të mesëm drejtues;
- IV. Punonjës të nivelit të lartë drejtues.

Niveli I: Merret me zbatimin e detyrave në këtë nivel, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, dhe në njohuritë e specialitetit.

- | | |
|---------------------------------------|-----------------|
| a) Ndhmës inspektor. | Klasa I.1 – I.4 |
| b) Inspektor në drejtoritë e bazës. | Klasa I.5 |
| c) Inspektor në drejtorinë e Tiranës. | Klasa I.6 |

Niveli II: Ka përgjegjësinë për punën konkrete, sipas drejtimeve të miratuara, bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja në një fushë të caktuar, përgatitjen e materialeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues, sipas hierarkisë administrative.

- | | |
|---|------------|
| a) Inspektor në Aparatin Qendror;
Kryetar dege në drejtoritë e bazës;
Përgjegjës seksioni në Drejtorinë e Tiranës. | Klasa II.1 |
| b) Kryetar dege në Drejtorinë e Tiranës;
Përgjegjës sektori/Grupi në Aparatin Qendror;
Zëvendësdrejtor dhe Kryetar dege në drejtoritë e bazës;
Inspektor në Aparatin Qendror. | Klasa II.2 |
| c) Zëvendëskryetar dege në Aparatin Qendror;
Punonjës i teknologjisë së Informacionit në Aparatin Qendror;
Shef baze/turni në Aparatin Qendror;
Inspektor në Aparatin Qendror. | Klasa II.3 |

Niveli III: Ka përgjegjësinë e programimit të punëve, menaxhimit dhe zbatimit të tyre, për drejtimet që mbulon, në përputhje me prioritetet e Shërbimit Informativ të Shtetit, të cilat duhen miratuar dhe aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë i njësive strukturore sipas drejtimeve përkatëse.

- | | |
|--|-------------|
| a) Kryetar dege në Aparatin Qendror; | Klasa III.1 |
| b) Drejtor drejtorie në drejtoritë e bazës;
Zëvendësdrejtor drejtorie në Aparatin Qendror;
Zëvendësdrejtor dhe Kryetar dege në Drejtorinë e Tiranës;
Kryetar dege dhe përgjegjës i njësive funksionale. | Klasa III.2 |

Niveli IV: Ka përgjegjësi për menaxhimin e punës në Shërbimin Informativ të Shtetit,

përcaktimin e strategjisë dhe hartimin e politikave të përgjithshme në fushat që mbulon njësia e tij strukturore, përdorimin me efikasitet të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj., me qëllim arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e produktit përfundimtar, Drejtorit apo zv/Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

a) Këshilltar;
Drejtor drejtorie në Aparatin Qendror;
Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Tiranës;
Zëvendës drejtor departamenti.

Klasa IV.1

b) Shef kabineti
Drejtor Departamenti.

Klasa IV.2

Lidhja nr.2

(Ndryshuar me VKM nr. 605, datë 27.4.2009; nr. 627, datë 8.7.2010; nr. 561, datë 11.8.2011; nr. 499, datë 1.8.2012)

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE SIPAS KLASIFIKIMIT TË FUNKSIONEVE, PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT

Nivelet e klasifikimit	Klasifikimi i punonjësve sipas niveleve	Klasa për çdo nivel klasifikimi	Paga bazë mujore për klasë në lekë	Shtesa për vjetërsi në %	Shtesa për gradë në %
1	2	3	4	5	6
I	Punonjës mbështetës	I.1	21000	1%	2%
		I.2	23 000	1%	2%
		I.3	26 500	1%	3%
		I.4	29500	1%	5%
		I.5	38100	1%	6%
		I.6	39000	1%	6%
II	Punonjës të nivelit zbatues	II.1	43100	1%	8%
		II.2	46200	1%	12%
		II.3	47700	1%	12%
III	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	III.1	51200	1%	14%
		III.2	52800	1%	16%
IV	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	IV.1	56800	1%	20%
		IV.2	64300	1%	20%
Jashtë klasifikimit	Inspektor i Përgjithshëm në SHISH		126000	0%	0%